

prespaNET

A NETWORK OF ENVIRONMENTAL NGOS FOR PRESPA



Liqenet e Prespës në Udhëkryq: Uji Ynë, E Ardhmja Jonë

SOCIETY FOR
THE PROTECTION
OF PRESPA



MACEDONIAN
ECOLOGICAL
SOCIETY



PPNEA

PROTECTION AND PRESERVATION OF NATURAL ENVIRONMENT IN ALBANIA
SINCE 1991

Pse ishte i nevojshëm ky rishikim literature

Pellgu i Liqeneve të Prespës - i ndarë nga Shqipëria, Greqia dhe Maqedonia e Veriut - është një nga ekosistemet ndërkufitare të ujërave të ëmbla më të vlefshme të Evropës. Liqenet dhe ligatinat e saj mbështesin biodiversitetin e rrallë, bujqësinë, peshkimin, turizmin dhe komunitetet lokale. Meqenëse liqenet ndahen nga tre vende, ajo që ndodh në një pjesë të pellgut ndikon të gjithin.

Gjatë dekadave janë ndërmarrë shumë studime shkencore për ujërat e Prespës. Megjithatë, njohuritë kanë mbetur:

- të shpërndara nëpër vende dhe institucione të ndryshme
- me cilësi dhe aksesueshmëri jo të njëjtë
- ndonjëherë të vjetëruara
- dhe në mjaft raste kontradiktore

Dialogu me palët e interesuara në lidhje me ujërat e Prespës është i vazhdueshëm, por propozimet ndonjëherë bazohen në keqkuptime. Menaxhimi efektiv ndërkufitar është i pamundur pa një bazë të përbashkët provash.

Në kuadër të **Projektit PrespaNet III**, një grup pune trepalësh shqyrtoi në mënyrë kritike më shumë se 120 dokumente shkencore, duke përfshirë raportet shtetërore, studimet e OJQ-ve, botimet akademike dhe të dhënat e monitorimit, duke u përqendruar kryesisht në botimet e shekullit të 21-të. Qëllimi ishte të kuptohej gjendja e ujërave tona dhe çfarë mund të sjellë e ardhmja.

Qëllimi nuk ishte të ndërmerreshin kërkime të reja, por t’u jepej përgjigje tre pyetjeve themelore:

- Çfarë dimë me siguri të arsyeshme?
- Çfarë mbetet e paqartë?
- Çfarë duhet studiuar në mënyrë urgjente?



Gjetja Kryesore: Një Bazë Njohurish e Fragmentuar

Edhe pse puna shkencore në Prespë është e gjerë, rishikimi i literaturës identifikoi dobësi strukturore:

- Shumica e studimeve përqendrohen vetëm në një vend, pavarësisht se pellgu është i përbashkët.
- Sistemet e monitorimit ndryshojnë midis vendeve, nëse ato ekzistojnë.
- Të dhënat shpesh janë të paarritshme ose nuk janë të disponueshme publikisht.
- Mungon modelimi shumëvjeçar duke përdorur simulime moderne hidrologjike; shumë studime mbështeten në metoda të vjetruara «në gjendje të qëndrueshme».
- Studimet ekologjike rrallë lidhen me të dhënat hidrologjike.

Në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, monitorimi sistematik mjedisor është i kufizuar, ndërsa në Greqi një sistem i strukturuar monitorimi ka funksionuar vetëm që nga viti 2012 sipas ligjit të BE-së.

Rezultati është një tablo shkencore e paplotë - një enigmë me pjesë të cilat mungojnë.

Liqenet dhe lumenjtë e Prespës nuk janë vetëm peizazhe të bukura. Së bashku me ujërat nëntokësore, ato janë:



Burimi ynë i ujit të pijshëm



Baza e bujqësisë sonë



Një themel për peshkimin dhe turizmin



Një shtëpi për kafshë të rralla të egra



Pjesë e identitetit dhe trashëgimisë sonë



Cilësia e ujit

Rënia dramatike e Nivelit të Liqenit të Prespës së Madhe

Një nga gjetjet më të qarta dhe më alarmuese ka të bëjë me **nivelet e ujit**.

Të dhënat shkencore konfirmojnë se:

- Liqeni i Prespës së Madhe ka përjetuar një rënie të madhe gjatë fundit të shekullit të 20-të, e cila vazhdon me ritme të ndryshme deri më sot
- Nivelet e ujit mbeten të ulëta krahasuar me kushtet historike
- Vëllimi i liqenit është ulur ndjeshëm në dekadat e fundit

Pse kjo ka rëndësi në nivel lokal:

1. Nivelet më të ulëta të ujit ndikojnë në habitatet e shumimit të peshqve
2. Vija bregliqenore ndryshon dhe livadhet e lagështa tkurren
3. Disponueshmëria e ujit për bujqësi bëhet më pak e besueshme
4. Turizmi ndikohet ndjeshëm

Pse po ndodh kjo?

Interpretimi shkencor mbizotërues është:

Reshjet e reduktuara dhe ndryshimet klimatike

Kufizimet afatgjata të reshjeve të shiut dhe të borës, veçanërisht gjatë stinëve të lagështa, konsiderohen faktori kryesor nxitës.

Shfrytëzimi i ujit për Ujitje

Shfrytëzimi i ujit për bujqësi kontribuon në rënien e nivelit të liqenit, por mungon një përcaktim sasior i besueshëm. Shifrat zyrtare të marrjes së ujit mund të nënvlerësojnë përdorimin real.

Çfarë NUK është e mbështetur fuqimisht?

- Humbje të rritura për shkak të aktivitetit tektonik
- Funksionimi i portës së kanalit Koula

Këtyre shpjegimeve u mungojnë prova shkencore bindëse.



7

Cilësia e ujit & gjendja ekologjike

Eutrofikimi Gradual dhe Stresi i ekosistemit

Rishikimi i literaturës tregon një model të pasurimit gradual të lëndëve ushqyese dhe eutrofikimit të Liqeneve të Prespës.

Burimi kryesor: Shkarkimet bujqësore (plehurat dhe ndotja jo-pikësore).

Ndikimet e vëzhguara:

- Pakësim sezonal i oksigjenit.
- Lulëzime të përsëritura të algave dhe cianobaktereve.
- Ndryshime në komunitetet e planktonit.
- Shenja të degradimit ekologjik lokal.

Metalet e rënda dhe shumica e ndotësve organikë në përgjithësi mbeten brenda kufijve të lejuar, por prania e tyre sinjalizon ndikim të vazhdueshëm nga burimet bujqësore dhe të ujërave të zeza.




Boshllëqet kritike përfshijnë:

- Monitorim i kufizuar i cianotoksinave dhe ndotjes së sedimenteve.
- Mungesë e të dhënave mbi ndotësit modernë (mikroplastikat, pesticide të reja).
- Vlerësime ekologjike të fragmentuara.
- Integrim i dobët i të dhënave biologjike dhe hidrologjike.

Është e rëndësishme të theksohet se, edhe nëse burimet e ndotjes mbeten të qëndrueshme, rënia e vazhdueshme e nivelit të ujit mund të përkeqësojë kushtet ekologjike duke përqendruar lëndë ushqyese dhe ndotës.

Pse kjo ka rëndësi në nivel lokal:

- Cilësia e ujit ndikon tek peshqit, shpendët dhe biodiversitetin në tërësi.
- Ndikon në turizëm dhe perceptimin publik.
- Mund të rrisë kostot e trajtimit të ujit.
- Mund të ndikojë në qëndrueshmërinë afatgjatë të tokës dhe bujqësisë.



Ndryshimet klimatike si një përforcues i kërcënimit

Pellgu i Prespës është pjesë e rajonit të Mesdheut, një nga pikat e nxehta të ndryshimeve klimatike në Evropë.

Nuk ka konsensus të plotë shkencor mbi kontributin e saktë të ndryshimeve klimatike në rënien historike të nivelit të ujit, por ndryshueshmëria klimatike mbetet shpjegimi mbizotërues.

Trendet e vëzhguara dhe të parashikuara përfshijnë:

→ Rritja e temperaturave

→ Reshjet e reduktuara

→ Thatësirat më të shpeshta

→ Rritja e avullimit

→ Kërkesa më e madhe për ujë dhe ujitje

Ndryshimi i klimës amplifikon të gjitha presionet ekzistuese:

- Zvogëlon vëllimet e ujit dhe kështu rrit përqendrimin e ndotësve
- Rrit avullimin dhe kërkesën për ujë në bujqësi, ndërsa kulturat bujqësore janë të stresuara nga temperaturat e rritura sezonale
- Kërcënon biodiversitetin vendas dhe qëndrueshmërinë e ekosistemit

Prandaj, **përshtatja ndaj klimës duhet të jetë qasje qendrore për të gjithë menaxhimin dhe vendimmarrjen e ardhshme**



Sfidat e tashme dhe të së ardhmes

Rishikimi zbulon një sistem ujqor ndërkuftar nën presion të konsiderueshëm dhe shumëplanësh. Ai arrin në përfundimin se sfidat përkatëse janë thellësisht të ndërlikura.

1. Fragmentimi i të dhënave dhe izolimi institucional

- Monitorimi është i paqëndrueshëm përtej kufijve.
- Ndarja e të dhënave është e kufizuar.
- Nuk ekziston një bazë të dhënash qendrore trepalëshe.
- Kërkimet shkencore shpesh janë afatshkurtër dhe të bazuara në projekte.
- Institucionet shtetërore shpesh veprojnë të izoluara.

Kjo situatë, e kombinuar me «enigmën e pazgjidhur hidrologjike», e bën të vështirë të kuptohet plotësisht se çfarë po ndodh dhe të planifikohet së bashku.

Pa informacion të përbashkët, besimi dhe bashkëpunimi bëhen më të vështira.

Pa të dhëna të koordinuara, konsensusi shkencor dobësohet dhe politika bëhet joefikase.

2. Boshllëku i Qeverisjes

Të tre vendet veprojnë duke pasqyruar ndryshime në:

- Kornizat ligjore,
- Kapacitetet institucionale,
- Detyrime për monitorimin.

Nuk ka një mekanizëm të qëndrueshëm trepalësh për:

- Vlerësimin e përbashkët të ujit,
- Planifikimin e koordinuar,
- Vendimmarrjen e bazuar në prova.

Ky boshllëk në qeverisje lejon që keqkuptimet të ndikojnë në debatin dhe politikat publike dhe nuk lejon ndonjë përparim të rëndësishëm në menaxhimin e ujërave që janë një burim vërtet i përbashkët.

3. Kërcënime në vijim

Rreziqet e kuptuara dobët përfshijnë:

- Mikroplastikat dhe pesticidet moderne,
- Reziliencia e ekosistemit ndaj thatësirës së përsëritur,
- Presionet socio-ekonomike nga disponueshmëria e reduktuar e ujit për bujqësinë.

Pellgu mbetet i ndjeshëm ndaj kërcënimeve që ende nuk monitorohen në mënyrë sistematike.



Rruga përpara

Prioritetet Strategjike për Shkencën dhe Menaxhimin

Rishikimi bën thirrje për një **ndryshim paradigmë**.

Prioriteti 1: Krijimi i një Kornize Trepalëshe për Monitorim dhe të Dhëna

Është urgjentisht i nevojshëm një sistem i harmonizuar, duke përfshirë:

- Monitorim të vazhdueshëm hidrometeorologjik.
- Matje të reshjeve dhe borës në lartësi të mëdha.
- Përcaktim të besueshëm të sasisë së ujit të përdorur për ujitje.
- Mostra të standardizuara të cilësisë së ujit.
- Monitorim të ndotësve të rinj.
- **Një platformë të dhënash trepalëshe të aksesueshme publikisht** si referencë zyrtare për pellgun.

Transparenca është themelore për besimin.

Prioriteti 2: Zhvillimi i një Modeli të Integruar Prespa-Ohër

Një model i integruar dhe afatgjatë i simulimit për ujin duhet të:

- Kombinojë ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe cilësinë e ujit.
- Simulojë skenarët e klimës dhe të përdorimit të ujit.
- Përcaktojë sasinë e faktorëve që ndikojnë në rënien e liqenit.
- Testojë ndërhyrjet e menaxhimit përpara zbatimit të tyre.
- Identifikojë pikat ku rënia e nivelit të ujit shkakton ndryshime ekologjike të pakthyeshme.

Ky mjet do ta transformonte debatin si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkufitar në një planifikim të bazuar në prova.

Prioriteti 3: Nxitja e Kërkimit Ndërdisiplinor dhe të Synuar

Kërkimet në të ardhmen duhet të jenë ndërdisiplinore që lidhin hidrologjinë me gjeologjinë, ekologjinë, agronominë dhe socio-ekonominë. Ato duhet të trajtojnë:

- Kuantifikimin e fluksit të ujërave nëntokësore.
- Lidhjen hidraulike të kanalit të Prespës së Vogël-Koula me Prespën e Madhe.
- Rugët e lëndëve ushqyese dhe ndotëse, duke përfshirë mikroplastikat dhe pesticidet.
- Reziliencën e ekosistemit.
- Përdorimin e ujit për ujitje, efikasitetin e përdorimit të ujit në bujqësi dhe stimujt socio-ekonomikë për bujqësi të qëndrueshme.

Shkenca duhet të jetë e bazuar në hipoteza dhe e orientuar drejt menaxhimit.

Prioriteti 4: Forcimi i lidhjeve shkencë-politikë-praktikë

«Interpretimi i përbashkët» i zhvilluar përmes këtij rishikimi literature duhet të formojë bazën për zhvillimin e një vizioni të përbashkët dhe të bazuar në prova për të ardhmen e pellgut. Kjo përfshin përkthimin e rezultateve komplekse shkencore në plane menaxhimi të zbatueshme, të tilla si:

- Plane trepalëshe për emergjenca në rast thatësire.
- Programe të përbashkëta për reduktimin e nutrientëve.
- Strategji të qëndrueshme bujqësore.

Bujqësi e qëndrueshme ndaj klimës dhe e bazuar në natyrë

Duke pasur parasysh ekonominë bujqësore të Prespës:

→ Sistemet bujqësore duhet të bëhen më reziliente ndaj klimës

→ Nevojitet diversifikimi i kulturave dhe praktikave

→ Përdorimi i ujit duhet të bëhet më efikas

→ Humbja e plehrave duhet të reduktohet

→ Duhet të promovohen zgjidhjet e bazuara në natyrë (ripyllëzimi, restaurimi i tokës, sistemet e hijëzimit)

→ Duhet të forcohet mbështetja financiare për praktikatat e qëndrueshme

Qëllimi nuk është të reduktohet bujqësia - por ta bëjmë atë më të sigurt dhe të qëndrueshme.

Mesazhi përfundimtar: Nga sfida shkencore në sfidën e qeverisjes - Një thirrje për bashkëpunim ndërkufitar

Literatura shkencore ofron një bazë të fortë, por të paplotë, që tregon drejtimin e ndryshimit dhe ashpërsinë e kërcënimeve.

Sfida përcaktuese nuk është thjesht vetëm shkencore.

Është një sfidë e:

- Qeverisjes,
- Bashkëpunimit,
- Kapaciteteve Institucionale dhe
- Besimit të ndërsjelltë.

Prespa mund të bëhet ose një model i qeverisjes bashkëpunuese evropiane të ujit - ose një rast studimi i mundësisë së humbur.

E ardhmja e ekosistemit të Prespës dhe e komuniteteve që ndikohen prej tij, varet nëse Shqipëria, Greqia dhe Maqedonia e Veriut mund të shkojnë përtej qasjeve kombëtare të fragmentuara dhe të përqafojnë një menaxhim vërtet të integruar, bashkëpunues dhe të bazuar në shkencë të ujërave dhe trashëgimisë së tyre natyrore të përbashkët.



Një shënim i fundit për kujdesin e nevojshëm!



- Edhe nëse përpjekjet e monitorimit do të shumëfishoheshin dhe koordinoheshin përtej kufijve
- Edhe nëse të gjitha të dhënat do të ishin të arritshme dhe të ndara
- Edhe nëse do të kryheshin projekte kërkimore për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve shkencore të mbetura,

Nuk do të mjaftonte për të bërë një ndryshim të konsiderueshëm në atë që e ardhmja do t'u sjellë njerëzve dhe natyrës në pellgun e Prespës. Duhet të merren vendime të bazuara në shkencë dhe ndërhyrjet duhet të planifikohen dhe zbatohen bashkërisht. Këto vendime dhe plane duhet të jenë domosdoshmërisht trepalëshe dhe jo të njëanshme.

Tre vendet duhet të bashkëpunojnë dhe të veprojnë tani!



Ky botim bazohet në raportin:

«Mbledhja dhe vlerësimi kritik i literaturës shkencore mbi gjendjen e ujërave të Prespës - Sinteza e gjetjeve»

nga Akis Zarkadoulas

Hartimi dhe redaktimi i tekstit:

Vivi Roumeliotou, Chara Vlachou, Giorgos Catsadorakis, Myrsini Malakou

Përkthimi nga anglishtja:

PPNEA

Material fotografik:

© Arkivi i SPP | Christina Ninou (Foto e kopertinës)

© Achilleas Chiras (faqja 5)

© Arkivi i SPP | L. Nikolaou (faqja 6)

© Arkivi i SPP | Myrsini Malakou (faqet 8-9)

© Arkivi i SPP | Charis Nikolaou (faqet 10-11)

© Arkivi i SPP | Christina Ninou (faqet 12-13)

© Arkivi i SPP | Daphne Mantziou (faqja 14)

© Shoqata Ekologjike Maqedonase | Slave Nakev (faqet 16-17)

© Arkivi i SPP | Francisco Márquez / The Living Med (faqja 18)

Burimi i hartës faqja 3: Bashkimi Evropian, përmban të dhëna të modifikuara të Copernicus Sentinel 2026, të përpunuara me Copernicus Browser

Diagrama faqja 7: Dr. Giorgos Parisopoulos

Dizajni grafik:

Productive Land – www.p-l.gr



Projekti PrespaNet III – Ruajtja e Biodiversitetit në Prespën Ndërkufitare (2024-2027), i financuar nga Fondacioni i Natyrës Prespa-Ohri (PONT) dhe Fondacioni Bamirës Aage V. Jensen dhe i menaxhuar nga EuroNatur



euroNATUR